

**Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët
për vitin aktual akademik 2022/23 i krahasuar me dy vitet paraprake
2020/21 dhe 2019/20**

Programi: Inxhinieri Industriale me Informatikë

1. Hyrja

Në kuadër të këtij fakulteti, **Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës** ofrohet programi i studimeve *Inxhinieri Industriale dhe Informatikë* (tash *Inxhinieri Industriale me Informatikë*), në ciklin e parë, pra në bachelor, programi i studimeve në *Informatikë të Aplikuar*, në ciklin e parë, pra në bachelor, si dhe programi i studimeve në *Inxhinieri dhe Informatikë* (tash *Inxhinieri dhe Menaxhimi i Prodhimit*), në ciklin e dytë, pra në master.

Programi Inxhinieri Industriale me Informatikë në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Informatikës gjatë vitit akademik 2021/22 ka ofruar mësim për studentet sipas plan-programit të Akredituar në vitin 2019 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA). Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës ka një staf të kualifikuar dhe ka ambiente moderne të punës të cilat u mundësojnë studentëve të fitojnë shkathtësitë e duhura për profesionin, të cilin do ta ushtrojnë në të ardhmen.

Misioni i programit është të zhvilloj kadro të specializuara të profesionistëve në fushën e Inxhinierisë dhe TI, me fokus në atë zhvillimin dhe dizajnin e produkteve duke përdorur teknologjinë dhe aplikacionet më moderne të TI-së, të cilat i përshtaten lehtë kërkesave të tregut të punës. Ky mision është në harmoni me misionin e institucionit “...të përgatitim profesionistë të kualifikuar dhe qytetarë të edukuar e të përgjegjshëm për të zhvilluar një karrierë profesionale dhe për të udhëhequr një jetë produktive.”

Në kemi qëllim që të krijojmë profesionist në fushën e *Inxhinieri Industriale me Informatikë* duke ndihmuar në strukturimin dhe organizimin e kompanive industriale për të përmirësuar zhvillimin e kompanisë si dhe gjenerimin e ideve që avancojnë praktikën e Inxhinierisë-Informatikës së aplikuar në Industri.

Raporti përmban të dhëna për vlerësimin e programit nga studentet dhe për vlerësimin e mësimdhënësve nga studentet në programin *Inxhinieri Industriale me Informatikë* për vitin aktual 2021/22 i cili krahasohet me dy vitet paraprake 2020/21 dhe 2019/20.

2. Raporti i përmbledhur i vlerësimit të cilësisë (program, mësimdhënës)

Raporti i përmbledhur - për dy fushat (program dhe mësimdhënës) paraqet ne Tabelën nr. 1 - statistikën për vitin akademik 2021/22 (krahasuar me dy vitet paraprake), i ilustruar edhe ne Fig.1. Pyetjet për dy fushat kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- Pajtohem pjesërisht; 4-Pajtohem; dhe 5- Pajtohem plotësisht).

Tabela.nr.1 - Vlerësimi i cilësisë sipas fushave

	Vitet Paraprake			Viti aktual
	2019/20	2020/21	2021/22	2022/23
Vlerësimi mësimdhënës/nxënës (programi)	3.99	3.76	3.82	3.98
Vlerësimi i stafit akademik	/	/	4.3	4.4

Nga raporti përmbledhur i paraqitur në tabelën nr.1 në kuadër të fushës së vlerësimit të programit, gjegjësisht të mësimdhënës dhe mësimnxënës shohim një vlerësim konstant në rritje të cilësisë nëpër katër vitet akademike.

Duke i u referuar tabelës, vlerësimi i cilësisë (Vlerësimi mësimdhënës/nxënës (programi) për katër vitet akademike kemi një ngritje për çdo vite (tri vitet e fundit) notën 3.76 në 2020/2021 dhe deri në vitin 2022/2023 me notën 3.98 që konsiderohet si vlerësim shumë i mirë. Në kuadër të fushës të vlerësimit të stafit akademik është një vlerësim në ngritje dy vitet e fundit por gjithsesi mbi notën 4 nëpër dy vite nga studentët, për vitin 2021/2022 dhe vitin 2022/2023, dy vitet akademike vlerësimi është me notën mbi 4.3 për vitin 2021/2022 dhe 4.4 për vitin 2022/2023 që është një vlerësim shumë i mirë dhe premtues për të ardhmen e këtij programi.

3. Raporti i vlerësimit të Programit

Vlerësimi i programit **Inxhinieri Industriale me Informatikë** 2021/22 (i krahasuar me vitin paraprake) është realizuar përmes pyetësorëve i cili përmban 20 komponente, ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga studentët e programit përkatës. Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Bazuar në rezultate të vlerësimit të programit - mësimdhënës dhe mësim-nxënës të paraqitura në tabelën nr.2, vërejmë se të gjitha komponentët e këtij sesioni janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, nota mesatare e vlerësimit të programit për të tri vitet akademike është pak nën 4 që është një vlerësim shumë i mirë.

Tabela nr.2 – Vlerësimi i programit – Inxhinieri Industriale me Informatikë

	Vitet paraprahe			Viti aktual
	2019/20	2020/21	2021/22	2022/23
Materialet e prezantuara gjatë ligjëratave ju ofrohen studentëve rregullisht,		3.71	3.71	4.00
Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit,		4.05	4.05	4.11
Syllabuset e lëndëve ofrohen me kohë studentëve,		3.86	3.86	4.11
Studentët janë të njoftuar me orarin e konsultimeve të mësimdhënësve,		3.95	3.95	4.09
Orari i konsultimeve me mësimdhënësit respektohet,		3.76	3.76	4.14
Që në fillim të vitit studentët janë të njoftuar me mënyrën e vlerësimit për lëndën përkatëse,		3.86	3.86	4.17
Metodat e mësimdhënies ofrojnë mënyrën më të mirë të arritjes së rezultateve të mësimnxënies,		3.90	3.90	4.00
Mësimi on-line (përmes Microsoft Teams) nuk dallon shume nga ai në klasë / Sallat e mësimit janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për konkretizimin e mësimit		3.67	3.67	3.60
Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) është i lehtë për përdorim dhe i plotëson nevojat e studentëve / Raporti në mes të pjesës teorike dhe laboratorike(praktike) të lëndëve është adekuat		3.67	3.67	4.06
Sallat e mësimit janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për mësim cilësorë / Studentit është i lirë që vet të përcaktohet për lënde zgjedhore		3.71	3.71	4.09
Ekziston një lidhje e mirë e mësimit teorik dhe atij praktik / Orari i mësimit shpallet me kohë		3.62	3.62	3.83
Studenti është i lirë që vet të përcaktohet për lëndët zgjedhore / Orari i shpallur i mësimit respektohet nga mësimdhënësit		3.62	3.62	3.91
Orari i mësimit shpallet me kohë / Programi i studimit është aktual me zhvillimet në këtë disiplinë te studimit		3.95	3.95	4.11
Orari i shpallur i mësimit respektohet nga mësimdhënësit / Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në univ. e vjetra		3.81	3.90	4.14
Programi i studimit është në përputhje me nevojat e tregut të punës / Angazhimi i studentit në lëndë është e balancuar (nuk është e mbingarkuar) / Vlera e ECTS-së për lëndën është e llogaritur sipas ngarkesës së studentit		3.90	3.95	4.06
Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në Universitete të tjera / Puna praktike jashtë institucionit aplikohet me rregull		3.95	3.95	4.03
Angazhimi i studentit në lëndë është e balancuar (nuk është e mbingarkuar) / Komunikimi i udhëheqësve të programit me studentë është në shkallën e duhur		3.95	3.67	3.66
Puna praktike jashtë institucionit organizohet mirë nga universiteti / Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët		3.67	3.95	3.63
Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët / Mendimi im i përgjithshëm për këtë program te studimit është pozitivë.		3.95	3.95	3.86

Mendimi im i përgjithshëm për këtë program të studimit është pozitiv / Këtë program të studimit do t'ia sugjeroj edhe personave të tjerë		3.95	3.74	3.97
Mesatarja e vlerësimit të programit		3.74	3.82	3.94

Nga analiza për vlerësimin e programit nga studentet vijmë në përfundimin se për tri vitet akademike për të cilat janë prezantuar në tabelën nr.2 rezultatet ka një vlerësim konstant, disa nga 20 komponentet e vlerësimit janë të vlerësuar me note mesatare mbi 4 që është një vlerësim i shkëlqyeshëm dhe ka disa komponente që janë vlerësuar me note mesatare nën 4 që konsiderojmë se ka hapësirë për të rritur angazhimin me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm, duke u bazuar në përfundimet e nxjerra dalin rekomandime - komponentët që kërkojnë një angazhim më të madh për përmirësim të cilësisë janë: **Mësimi “on-line” përmes platformës Microsoft Teams e cila është përdorur gjatë kohës së pandemisë CoVid-19, Puna praktike jashtë institucionit organizohet mirë nga universiteti / Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët, Mënyra e vlerësimit të studenteve, Raporti në mes pjesës teorike dhe praktike – për këto komponente duhet angazhim i menaxhmentit dhe organizim më i mirë i stafit për ngritje të cilësisë dhe të rezultateve.**

4. Raporti i vlerësimit të mësimdhënësit

Raporti i vlerësimit për mësimdhënësit paraqet statistikën për vitin akademik 2021/22. Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Vlerësimi i mësimdhënësit/lëndës nga studentet është realizuar përmes pyetësorit i cili përmban 13 komponente për të cilat është gjetur nota mesatare. Rezultate e vlerësimit të mësimdhënësve janë paraqitura në tabelën nr.3.

Mësimdhënësit dhe lëndët të cilat janë pjesë të programit Inxhinieri Industriale me Informatikë janë vlerësuar me note mesatare të shkëlqyeshme (në të gjitha vitet - nota mbi 4.1) kjo tregon se studentet e kanë vlerësuar kënaqshmërinë e programit me rreth 88% që është një arriturë e jashtëzakonshme për këtë program dhe shpresë se në vitet në vazhdim do të kemi rezultate shumë më të mira.

Duke analizuar detajet e raportit vijmë në përfundimin se ka disa mësimdhënës dhe lëndë të cilat kanë marrë një vlerësim më të lartë (mbi notën 4 në bazë të këtyre të gjeturave rekomandojmë që menaxhmenti i programit së bashku me mësimdhënësit dhe komitetin e programit duhet të angazhohen për të rritur nivelin e përgjegjësisë profesionale nga të gjithë mësimdhënësit në të gjitha lëndët duke bërë përpjekje që këto vlerësime të rriten edhe në vitet pasuese.